

Eda Kaja




GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Deklaratat e analizuara:

15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2016)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2016




Pasuria bruto është rritur 19.4 herë.

+ 1,106,047 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.


## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete në Bankë



Pasuritë e Luajtshme



Pasuritë e Paluajtshme



## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2016	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni	13,648,485	50.4%
Të ardhura nga aktiviteti privat dhe paga e bashkëshortit	5,588,865	20.6%
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	987,090	3.6%
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	6,847,400	25.3%
<b>Total</b>	<b>27,071,840</b>	<b>100%</b>



## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 13 vite rezultoi:

**Pa Probleme**

Në vitin 2005, subjekti Eda Kaja deklaroi shtesë aseti apartament banimi me vlerë totale 47,000 euro, nga e cila shlyen brenda vitit 10,000 euro të siguruar nga kredia bankare me të njëjtën shumë, ndërsa diferenca e papaguar 37,000 euro do shlyhet pjesërisht në vitin 2008, falë kredise së marrë në vlerë 30,000 euro. Gjatë vitit 2005 deklarohen gjithashtu: 1. shtesa aseti nga trashëgimia që përfshijnë apartament banimi, dyqan dhe garazh për të cilat nuk jepen vlera as detaje më shumë, 2. depozitë bankare në vlerë 25,551 euro, 3. huamarrje në vlerë 10,000 euro që shërben për mobilim shtëpie dhe 4. të ardhura 4,000,000 lekë nga shitja e një apartamenti banimi, i cili nuk rezultoi të jetë deklaruar më parë.

Në vitin 2008 subjekti deklaroi blerje apartament banimi në vlerë 41,600 euro, ku si burim financimi përveç të ardhurave vjetore shërbejnë të ardhura nga shitja e dyqanit të përmenduar më sipër në vlerë 23,000 euro.